

## **Statuti i Shoqërise me Përgjegjësi të Kufizuar BEKSTER sh.p.k.**

Në këtë statut

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;

### **Kreu I**

#### **Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

##### **Neni 1: Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

(1) Sot, më 14/07/2021, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin BEKSTER sh.p.k.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Z. Bekim Halimi**, i lindur me date 06/05/1972 ne Strugë, Maqedoni, banues ne adresen: RR.GLOBOÇIÇKA, NR.21, me shtetesi te MAQEDONISE, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes me Nr. K1244517 e leshuar ne date 11/01/2021.

##### **Neni 2: Objekti**

Zhvillim, prodhim, implementim dhe mirëmbajtje e programeve informatike (Software) në platformë të ndryshme. Produkte dhe shërbime në fushën e teknologjisë Informatike. Dhënie me qira të programeve informatike (Software).

##### **Neni 3: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me kufi te pacaktuar. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe per cfaredo shkak me vendim te ortakeve.

##### **Neni 4: Selia**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Njesia Administrative Nr.11, Rruga Dritan Hoxha, Pallati E88, Nr. Pasurie 1/572+1-54, Zona kadastrale 8210, Volume 32, Kt.2, Ap.11, Tirane, Shqipëri.

### **Kreu II**

#### **Kapitali i Regjistruar**

##### **Neni 5: Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar**

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1.000.000 LEK.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

I. Ortaku themelues Bekim Halimi, 1 (nje) kuote

lloji i kontributit : cash

dhe vlera e kontributit ; 1.000.000 LEK;

Vlera totale e kapitalit te regjistruar : 1.000.000 LEK (njemilion)

Vlera e paguar : 1.000.000 LEK (njemilion)

(2) Kontributet në para do të paguhen (plotësisht) menjëherë. Kontributet në natyrë do të kalojnë Shoqërisë menjëherë pas regjistrimit në QKB.

(3) Pagesat e kontributeve në para do të kryhet në llogarinë e shoqerise pranë Raiffeisen Bank, menjehere pas celjes se saj ne QKB.

#### **Neni 6: Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të papaguara**

(1) Administratorët mund t'u kërkojnë ortakëve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej \*30\* diteve kalendarike), në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

(2) Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

(3) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaje një interes mbi shumën e papaguar me një kamatëvonesë prej \*10\* % në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.

(4) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar. Administratorët mund të njoftojnë paraprakisht të paktën \*30\* ditë kalendarike personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumat e mundshme shtesë të kamatëvonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarin se në rast moszbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.

(5) Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Asamblese dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

(6) Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratorët konsiderojnë të përshtatshme.

(7) Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuotë por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.

#### **Neni 7: Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave së ortakëve, në përputhje me parashikimet e Nenit 87 të Ligjit 9901.

#### **Neni 8: Certifikatat e kuotave**

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

#### **Neni 9: Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar**

(1) Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

(2) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

#### **Neni 11: Blerja e Kuotave të Veta**

(1) Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritet tregtare".

### **Kreu III**

#### **Asambleja e Përgjithshme**

#### **Neni 12: Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**

(1) Administratorët, me kërkesën e ortakëve, sipas Nenit 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose poste elektronike (email) drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo me vonë se 7 dite përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.

(3) Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 13: Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call), audio ose audiovideo, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Administratorët caktojnë Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.

(3) Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

(4) Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.

(5) Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet, njoftimi do të degohet gjithë ortakeve jo me vonë se shtatë ditë përpara datës së caktuar dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.

(6) Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:

1. Kryetari; ose

2. një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortaku.

(7) Me përjashtim të kundërshtimit të një ortaku, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marre në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

(8) Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

**Neni 14:****Votat e Ortakëve**

- (1) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
- (2) Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar.

**Neni 15:****Votimi me Prokurë**

- (1) Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratorët):  
BEKSTER sh.p.k.

Unë / Ne i / të nënshkruari / t,....., në cilësinë e ortakut / ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj / më....., ose në pamundësi të tij,....., në cilësinë e përfaqësuesit / ve tim / tonë për të votuar në emër / emrat tim / tonë dhe në llogarinë time / tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më *\*data / muaji / viti\** dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Nënshkruar më *\*data / muaji / viti\**.

- (2) Në rastet kur dëshirohet tu jepet ortakëve mundësia për të udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën veprimit, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratorët) :

BEKSTER sh.p.k.

Unë / Ne i / të nënshkruari / t,....., në cilësinë e ortakut / ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj / më....., ose në pamundësi të tij,....., në cilësinë e përfaqësuesit / ve tim / tonë për të votuar në emër / emrat tim / tonë dhe në llogarinë time / tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më *\*data / muaji / viti\** dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Kjo formë do të përdoret për vendimet e përmendura më poshtë:

Vendimi Nr. 1 \*pro \*kundër

Vendimi Nr. 2 \*pro \*kundër.

Përveç udhëzimeve të tjera, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme. Nënshkruar më *\*data / muaji / viti\**

- (3) Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratorët depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

- (4) Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*) sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

#### Neni 16: Përfashtimi nga e drejta e votës

(1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

(2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### Neni 17: Hetimet e posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

#### Kreu IV

#### Administratorët

#### Neni 18: Emërimi i Administratorëve

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të Nenit 207 të Ligjit 9901, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:  
(mbiemrat, emrat, adresat):

dhe specimenët e nënshkrimit:

- Bekim Halimi

BEKIM HALIMI *Halimi Bekim*

(4) Administratori **Bekim Halimi** do të caktohet si Kryetar i mbledhjeve të Administratorëve deri në zgjedhjen nga mbledhja e parë e zakonshme.

#### Neni 19: Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të therasin Asamblesë së Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
  - shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 20: Perfaqesimi**

- (1) Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit 9901.
- (2) Administratori, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.
- (3) Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## **Neni 21: Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorëve**

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të Nenit 95 të Ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Administratorëve të tjerë në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e Administratorëve, vendos ta shkarkojë nga detyra.

#### **Neni 22: Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorëve**

(1) Administratorët shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e Nenit 97 të Ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

(2) Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.

(3) Administratorëve mund t'iu paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Administratorëve ose të komiteteve të Administratorëve ose të Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

#### **Neni 23: Mbledhjet e Administratorëve**

(1) Mbledhjet e Administratorëve do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.

(2) Asambleja e Përgjithshme cakton njërin prej Administratorëve me detyrën e Kryetarit të mbledhjes së Administratorëve, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo mbledhje të Administratorëve në të cilat ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga ora e caktuar për mbledhjen, Administratorët e pranishëm mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

(3) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

(4) Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratorëve, ose nga një komitet i Administratorëve, apo nga persona të cilët veprojnë si Administratorë, pavarësisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e një Administratori ose njëri prej tyre ka qenë i kualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëjloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si Administratorë dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

(5) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë Administratorët që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Administratorëve ose nga komiteti i Administratorëve do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëjloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Administratorëve, e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

#### **Neni 24: Kufizimet në Votimet e Administratorëve**

(1) Administratorët nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Administratorëve për çështje në të cilin këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit 9901, deri në momentin kur në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:

- të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe
- të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Vota e Administratorit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë. Dispozitat e nenit 89 të Ligjit "Per tregtatert dhe shoqerite tregtare" do të zbatohen lidhur me përjashtimin e Administratorit nga vendimet e marra në këtë mbledhje.

(3) Në rast se në mbledhjen e Administratorëve ose të komitetit të Administratorëve diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një Administratori, çështja mund të drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo Administrator të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë.

#### **Neni 25: Procesverbalet e Mbledhjeve të Administratorëve**

Administratorët kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e:

1. të gjitha takimeve të kryera nga Administratorët; dhe
2. të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjeve të Administratorëve dhe komiteteve të Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këto mbledhje.

### **Kreu V**

#### **Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

#### **Neni 26: Dividendët**

(1) Pas plotësimit të parashikimeve të Nenit 77 të Ligjit 9901, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

(2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumatat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumatat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota

emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

(3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

#### **Neni 27: Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar**

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit 9901, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

### **Kreu VI**

#### **Prishja dhe njoftimet**

#### **Neni 28: Prishja dhe likuidimi**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901.

Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me Nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

#### **Neni 29: Njoftimet**

(1) Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

(2) Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

(3) Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të shoqërisë, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të këtij Statuti (nëse zbatohet).

emrat dhe nënshkrimet e Ortakëve Themelues:

- Bekim Halimi

Tirane, me 14 / 07 / 2021

BEKIM HALIMI Halimi Bekim